

PERTEF LIÇI

814-1

α 73

Lëndinat
e yjeve

poezi

8JH-1

L73

Pertef Liçi

LËNDINAT E YJEVE

Poezi



SHËTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor
PERIKLI JORGONI

Piktore
SAFO MARKO

Reçensentë
Rudolf Marku,

Esnik Mustafaj

MOTËR, JETË

*Në llërët e pjekura nga dielli i jugut,
Ka ca shifra të shkruara me fije kashte,
Janë përmasat e ditëve të punës,
Është atje toka, mbledhur e pjesëtuar.*

*Është vjersha e përditshme e drithit, e ujit,
Që kjo poeteshë e shkruan me dorën e njomë
Nëpër piskun e vapës së gushtit,
Nëpër cikmën e kaltër të dhjetorit.*

*Dhe për mua e merr malli shumë,
Ndaj sonte më ka dërguar një letër:
— Shpirt i motrës, pres akoma t'i lexoj
Ato vjersha që të mbushën gjithë jetën.*

*S'i t'i them unë asaj që e kam motër,
Gjithë këtë jetë që vazhdon me mirësi,
Dhe se brenda aq gjëra të bukura bashkon,
Sa t'i hedhësh në letër s'ke mundësi.*

Ndaj, moj motër e dhimbsur, s'ke shpjegim.
Prej meje. Unë përgjigje s'do të kthej.
Nëse poezia ime nga koha ndahet një grimë,
Atëherë ti përgjigje të kërkossh patjetër.

PRISJA TË BËHESHA POET

Prisja të bëhesha poet
Që të shkruaja një këngë të bukur për ty,
Merrja penën, thosha erdhi ai çast,
Por befas, ti më ikje prej syve.

*Humbisje tutje, në rrugët me baltë,
Me një bluzë leshi e shami në kokë,
Degët e ullinjve i ngrinte si dallgë
Përballë teje era e dhjetorit.*

*Ti ngrohje gishtërinjtë me frymë,
Mblidhje kokrrat e ullinjve të rëna përdhe,
Të shkrinte në pëllëmbë argjendi i brymës.
Dhe mua do më kesh kujtuar atje.*

*Çoheshe pastaj, mendoheshe: — Ç'të pres?
Nxirrje rrënjë të kalbura dhe gurë,
Çlodheshe në këmbë, vije duart në mes,
Po përsëri, atje, do të jem kujtuar unë.*

*Eh! Unë prisja të bëhesha poet
Dhe të shkruaja pastaj një këngë të bukur,
Turp për mua që s'erdha në jetën tënde, vajzë,
Nder për ty që në këngën time s'u ktheve më
kurrë.*

SA MILIARDË ËSHTË BOTAI

*Ju thoni u bë bota 5 miliardë njerëz
Dhe u dashka ta besoj!*

*Po miliona maska,
Po miliona role,
Që futen midis?!*

*Po priftërinjtë dhe murgeshat,
Grevëthyesit dhe artistët surrealistë,
Burokratët dhe hipokritët
Dhe gjithfarë grykësish dhe vampirësh?!*

S'i pranoj kurrë në numrin e njerëzimit!

110 NGELET NJË ZOG 112

Tutje, kur shkoj arave të gjelbra,
Befas ndiej një brofëtimë prej tokës,
Rrahin krahët njëherësh e ngrihen në qiell
Tufa zogjsh.

Po pse më duket se dalin të gjithë
prej kraharorit tim?!

E ndërsa ngjitem lart e më lart,
Ndiej këtu midis brinjëve të mia,
Sikur më ka ngelur njëri...
në krahun e majtë...

Ai gjithmonë kërkon të fluturojë
E rreth flatrat.

SHIU

*Shiun vështroj nga dritarja
Si ma mbylli shtëpinë në këtë gropë të blertë,
U sul rrugëve, pyjeve, arave
E dalëngadalë nga sytë m'i fshehu.*

*Me një dritë të kaltër veshur nëna,
Pëshpërit te pragu: — O zot, ç'hata e madhe!
Qielli mbi tokë sikur ka rënë,
Telat elektrikë vishen me një push prej flake.*

*Fushës, bujqit s'e ndërpresin punën në këtë
tymësirë,
Të lagur gjer në palcë, baltrave e blerimeve,
Ndërsa burokrati mbyll perdet e zyrës,
Rrotullon çelësin në derë, fle gjumë në karrige.*

*Pemët mbi kafshimet e blerta të stuhisë,
Varin gjethet për të mjekuar lëkurën,
Vajzat e reja, me çizme përmes baltovinës,
Ia ndiejnë shijet në pikat sipër buzës.*